

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

SESIONI II

(I DETYRUAR)

VARIANTI **A**

E premte, 9 shtator 2011

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme artistike; koreografike; sportive; me kohë të shkurtuar

Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në poezi dhe në prozë.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dyja pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8a	8b	9a	9b	10a	10b	10c
Pikët														
Kërkesa	11	12a	12b	12c	13	14	15	16	17	18	19a	19b	20a	20b
Pikët														
Kërkesa	20c	21a	21b	22a	22b	23a	23b	23c	24a	24b	25a	25b	25c	25d
Pikët														

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I**Martesa e Halilit****(fragment)**

I- T'tanë për darkë Muji i ka ndalë.
 Kqyr shka bani Gjeto Basho Muji
 u ka vu një barrë dru t'vogël n'zjarrm,
 tre qind vetë pr i herë m'u xe.
 At'herë trimi u ka avitë bucelat,
 at'herë trimi u ka avitë fucijat;
 i'n bucelat plot raki,
 i'n fuçijat plot venë.
 Sa shpejt frima burrave u ka ardhë,
 sa shpejt gjaku trimave po u xehet!
 Kanë marrë llafin e po llafiten,
 kanë marrë gazin e po gazmojnë,
 Kanë nisë trimat Mujin p'e pvetin;
 "N'votër tande kem' qillue,
 mos na ki randë për një fjalë:
 pash një Zot, Muj qi t'ka dhanë,
 qysh Halilin s'e martove?,"

.....

II- "S'e kam lanë për pare pse nuk pata,
 s'e kam lanë, për vashë pse n'u mund hasa,
 s'kam dashtë vetë m'u martue!"
 "Pa ndigjo, more djalë ti djalë,-
 ka folë plaku Osman Aga.-
 Ditë e madhe nesër ka qillue,
 tridhjetë agë kanë me u bashku,
 tridhjetë vashat t'i kanë pru:
 njat ma t'mirën ke me e zgjedhë.
 Tridhjetë agë për hajr ta bajmë".
 S'pe len djali plakun ma me folë:
 "Zoti u vraftë, more agt' e Jutbinës!
 Nji be t'madhe qi kam ba,
 qi, ja martohem me gur e dhe,
 ja e kam marrë Tanushën e Krajlit!,"

Për pyetjet nga 1-7 rrethoni **vetëm** alternativën e saktë.

1. Cikli i Kreshnikëve përbëhet nga rapsodi ku u këndohet bëmave: **1 pikë**
- A) të dy personazheve kalorsiakë
 B) të heronjve romakë
 C) të heronjve grekë
 D) të dy vëllezërve dhe 30 shokëve të tyre
2. Si paraqiten ngjarjet në këngët e Ciklit të Kreshnikëve? **1 pikë**
- A) të thjeshta
 B) të ndërlikuara
 C) të hiperbolizuara
 D) të zvogëluara
3. Cikli i Kreshnikëve merr formën e këngëve legjendare nga: **1 pikë**
- A) prania e elementit të kuvendimit
 B) përfshirja e qënieve përrallore
 C) prania e natyrës së qetë
 D) kontradiktat midis grupeve shoqërore
4. Figura e Mujit në këtë fragment karakterizohet më shumë nga fakti që ai: **1 pikë**
- A) shfaq mençuri dhe vlera etike si i pari i familjes
 B) gëzon të drejtën për të folur si vëlla i Halilit
 C) nuk mundet të shprehet bindshëm mbi problemin që diskutohet
 D) e merr fjalën në kuvend në momentin më të keq
5. Figura tingullore e përdorur në vargjet:
At'herë trimi u ka avitë bucelat,
At'herë trimi u ka avitë fucijat, është: **1 pikë**
- A) asonanca
 B) aliteracioni
 C) onomatopeja
 D) anafora
6. Cili nga elementët e mëposhtëm i jep muzikalitet fragmentit? **1 pikë**
- A) krahasimi
 B) epiteti
 C) përsëritja
 D) hiperbola
7. Folja në vargun: *Zoti u vraftë, more agt' e Jutbinës!*, është në mënyrën: **1 pikë**
- A) dëshirore
 B) dëftore
 C) kushtore
 D) lidhore

8.

a) Cila është ngjarja kryesore në këtë fragment?

1 pikë

b) E papritura është pjesë e krijimtarisë popullore.
A kemi këtu ndonjë të papritur? Ç'efekt krijon ajo?

2 pikë

9.

a) Gjenerali në fragment një rimë foljore dhe një rimë emërore.

2 pikë

rimë emërore: _____

rimë foljore: _____

b) Përse shërbejnë këto rima?

1 pikë

10. Identifikoni në fragment momentin kur flitet për traditën e gostitjes si edhe përdorimin e numrit tridhjetë. Shpjegoni rolin e tyre në mesazhin që përcjellin në këto vargje.

a) vargjet ku flitet për traditën:

1 pikë

b) vargjet ku përdoret numri tridhjetë:

1 pikë

c) roli i përdorimit të tyre:

1 pikë

11. Si jepet në vargjet e mëposhtme diferenca midis *njeriut burrë* dhe *njeriut trim*?*Sa shpejt frima burrave u ka ardhë,
Sa shpejt gjaku trimave po u xehet?

2 pikë

12. Ndaluni në vargun: *T'tanë për darkë Muji i ka ndalë.*Ç'tregon fakti që Muji i ka ftuar të gjithë për darkë ose *t'tanë*? Pse këtë rol e luan Muji?
Në cilën klasë të fjalëve bën pjesë "t'tanë"?

a) _____ 1 pikë

b) _____ 1 pikë

c) _____ 1 pikë

PJESA II

Balzak

Evgjeni Grande (fragment)

*Prifti doli. Zonjusha Grande u ngjit në dhomën e vet dhe qëndroi tërë ditën vetëm, pa zbritur as për të ngrënë darkë, me gjithë lutjet e Nanosë. Në mbrëmje, kur erdhën mysafirët, ajo zbriti dhe e gjeti sallonin plot; kurrë ndonjëherë s'patën ardhur aq shumë. Lajmi i kthimit të Karlit dhe marrëzia e tradhtisë së tij, ishin përhapur në tërë qytetin. Po me gjithë kureshtjen që kishin vizitorët, Evgjenia mbajti një gjakftohtësi shembullore dhe asnjë nga brengat e brendshme, nuk u shfaq në fytyrë. Ajo u përgjigjej me buzëqeshje atyre që tregonin interes për të ose përdornin ndonjë shprehje melankolike. Nën vellon e mirësjelljes, ajo mundi ta fshehtë fatkeqësinë e vet.

*Aty rrotull orës nëntë, lodra mbaroi, dhe lojtarët, mbasi i paguan borxhet njëri-tjetërit, u ngritën dhe nisën të bënin muhabet. Në çastin kur po përgatiteshin të iknin të gjithë, mbasi ish bërë vonë, ngjau një e papritur, që buçiti dhe mori dhenë jo vetëm në Somyr, por në të gjithë rrethin dhe në të katër prefekturat.

- Ju qëndroni, zoti kryetar!- i tha Evgjenia zotit De Bonfons, kur ai po merrte bastumin për të dalë. Këto fjalë prekën që të gjithë sa ishin aty. Kryetari u zverdh nga fytyra dhe u detyrua të ulej.

- Milionat shkuan te kryetari!- tha zonjusha Degribonku.

- Kjo lodër na qenka ç'na qenka! Më e mira nga të gjitha!- tha prifti.

Dhe noteri shtoi: - Këtij i doli asua me tridhjetë dhe u bë tridhjetë e një.

Gjithësecili bëri nga një lodër fjalësh dhe ndërkohë që të gjithë shikonin trashëgimtarin të hipur në një pedestal, majë milionave të saj. Drama, që kish filluar nëntë vjet më parë, po merrte fund.

*T'i thuash kryetarit në sy të gjithë botës që të rrijë aty, kjo kish vetëm këtë kuptim: se ajo e kish zgjedhur për burrë. Në qytetet e vogla vihen re shumë zakonet dhe nuk quhet e sjellshme ajo vajzë që i flet në një mënyrë të tillë një burri. Ato fjalë të dala nga goja e një vajze kundrejt një burri, përbënin premtim solemn

- Zoti kryetar, - i tha Evgjenia, me një zë mekës kur mbetën vetëm. Unë e di pse kërkonte të bëheni burri im. Betohuni se do të më lini të lirë gjatë gjithë jetës sime dhe nuk do të kërkonte asnjë nga të drejtat, që i lejon martesë burrit ndaj gruas; me këtë kusht unë jam juaja. – Kur kryetari i ra më gjunjë, ajo shtoi, - Dale se s'kam mbaruar. Unë s'kam ndër mend t'ju gënjej, zotni. Zembrën time e ka pushtuar një dashuri që s'ka për t'u shuar kurrë. Pra, bashkëshortit tim unë mund t'i dhuroj vetëm miqësinë time. Unë nuk dua as të lëndoj zembrën time, as të veproj kundër ligjeve të zembrës sime. Që të mund të quheni burri im, zot i pasurisë sime, kërkoj nga ju një shërbim shumë të madh.

- Jam gati të bëj ç'të doni ju, - u përgjegj De Bonfonsi.

*Evgjenia nxori nga gjiri i vet njëqind aksione të bankës së Francës dhe ia dorëzoi duke i thënë:

- Merrni këto një milion e gjysmë franga dhe nisuni shpejt për në Paris. Jo nesër, jo sonte natën, po tashti në çast. Shkoni te zoti De Grasen, merrni emrat e të gjithë kreditorëve të tim ungi, mblidhni bashkë dhe paguajini jo vetëm kapitalet, po dhe interesin pesë për qind që nga dita e borxhit e gjer më sot. Kini kujdes dhe merrni një dëftesë të rregullt të përgjithshme noteriale. Ju jeni vetë gjykatës dhe më mirë nga ju s'ka kush mund ta bëjë këtë punë. Ju jeni njeri i ndershëm, fisnik dhe i besuar. Unë po i jap besim fjalës tuaj, dhe, nën mbrojtjen e emrit tuaj, do t'u bëj ballë sot e tutje tërë rreziqeve të jetës... Ne njihemi prej kohe aq të gjatë, sa mund të thuash se jemi të afërt. Unë nuk besoj se ju do të dëshironit të më bënit fatkeq. Ne duhet të jemi shumë zemërgjerë për njëri-tjetrin. Kryetari i ra më gjunjë trashëgimtares së pasur, duke u dridhur nga gëzimi dhe nga ankthi.

- Do të jem skllavi juaj, - tha ai.

Për pyetjet nga 13-18 rrethoni **vetëm** alternativën e saktë.

13. Romani *Evgjeni Grande* bën pjesë në: **1 pikë**
- A) Komedinë njerëzore
B) Komedinë hyjnore
C) Romanet kalorsiakë
D) Mitologjinë greke
14. Mbështetja në realitetin e kohës e bën veprën e Balzakut: **1 pikë**
- A) romantike
B) realiste
C) sentimentaliste
D) magjike
15. Fjala *zemërgjerë* nga pikpamja e formimit është: **1 pikë**
- A) e parme
B) e prejardhur
C) e përbërë
D) e përngjitur
16. Kryetema e romanit *Evgjeni Grande* është: **1 pikë**
- A) atdheu dhe lufta për pavarësi
B) dashuria gjatë luftës së dytë botërore
C) vdekja si fund i lumtur
D) kopracia dhe ndikimi i saj te njeriu
17. Fjalët që Evgjenia i thotë kryetarit, përbënin sipas zakonisht të provincës: **1 pikë**
- A) inferioritet
B) premtim solemn
C) sjellje të zakonshme
D) pabesi të hapur
18. Mënyra se si flet Evgjenia për paratë dhe veprimet me to në paragrafin e fundit tregojnë: **1 pikë**
- A) se ajo kishte ndryshuar edhe nga paraja
B) se Evgjenia ishte si më parë
C) lumturinë e pamasë të Evgjenisë
D) gjallërinë që ajo kishte fituar nga jeta
- 19.
- a) Lexoni fjalinë: *Nën vellon e mirësjelljes, ajo mundi ta fshehë fatkeqësinë e vet,*
- * Cila ishte fatkeqësia e Evgjenisë? **1 pikë**
-
- b) Me çfarë është e lidhur kureshtja e vizitorëve? **1 pikë**
-

20. Gjeni dy detaje në paragrafin e parë që tregojnë mënyrën se si Evgjenia e zotëron plotësisht veten dhe shpjegoni nëpërmjet tyre ndryshimin që ka pësuar ajo.

a) _____ **1 pikë**

b) _____ **1 pikë**

c) _____ **1 pikë**

21. Ndaluni në paragrafin e dytë. Çfarë i çudit njerëzit që rrethojnë Evgjeninë?

a) _____ **1 pikë**

b) Gjeni dhe shpjegoni ironinë në fjalët e priftit po në këtë paragraf. **2 pikë**

* ironia: _____

* pse është përdorur ajo: _____

22. Pse Evgjenia vendos të martohet? (Jepni dy arsye.)

a) _____ **1 pikë**

b) _____ **1 pikë**

23. Identifikoni dy kushte që Evgjenia i vë bashkëshortit të saj të ardhshëm. Si ndihet ai nga fjalët e saj?

a) _____ **1 pikë**

b) _____ **1 pikë**

c) _____ **1 pikë**

24. Ç'përshtypje ju jep sjellja dhe veprimi i kryetarit pas fjalëve të Evgjenisë. Cili është konkluzioni që nxirrni nga shprehja e fjalëve të tij të fundit: - *Do të jem skllavi juaj, - tha ai.*

a) _____ **1 pikë**

b) _____ **1 pikë**
